



BANKA POPULLORE E MAQEDONISË

Në bazë të nenit 48, paragrafit (1), pikës 3) nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.158/10, 123/12 dhe 43/14) dhe pika 22) nga Vendimi për mënyrën dhe kushtet e blerjes dhe shitjes së mjeteve të huaja pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.58/14), guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

UDHËZIM

për mënyrën e dorëzimit të të dhënave për transaksionet e realizuara në tregun valutor

1. Me këtë Udhëzim rregullohet mënyra e dorëzimit të të dhënave për transaksionet e realizuara në tregun valutor.

2. Bankat dorëzojnë deri te Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (më tutje në tekst: Banka Popullore) të dhëna për transaksionet e realizuara me klientët (rezident dhe jorezident, persona fizik dhe juridik) për shitblerjet e mjeteve të huaja pagesore, ku një nga valutat kontraktuale është denari.

Me miratimin dhe shlyerjen e kredive valutore, Marrëveshja e miratimit të kredisë konsiderohet si e përfunduar.

Të dhënat nga paragrafi (2) i kësaj pike, nuk dorëzohen deri te Banka Popullore.

Të dhënat për transaksionet e lidhura me aktvendime për pagesë të detyrueshme dorëzohen deri te Banka Popullore.

3. Të dhënat për transaksionet e realizuara dorëzohen në çdo 30 minuta në periudhën prej orës 8:00 deri 16:00.

Transaksionet e paraqitura pas orës 16:00 do të llogariten si transaksione të realizuara ditën e ardhshme të punës.

4. Të dhënat për transaksionet e realizuara në tregun valutor dorëzohen nëpërmjet shërbimit të platformës elektronike për tregti.

Nëse platforma elektronike për tregti nuk është operuese, banka e njofton Bankën Popullore nëpërmjet mjeteve tjera të komunikimit.

Pas rinisjes së funksionimit të platformës elektronike, banka fut të dhënat për të gjitha transaksionet e realizuara.

5. Të dhënat për transaksionet e realizuara me klientët i përmbajnë elementet në vijim:

RQR 1 (Raporti për qarkullimin e realizuar në tregun valutor)

Numri amëz i bankës	Numri rendor	Data e transaksionit	Numri amëz i blerësit	Numri tatimor i blerësit	Numri amëz i shitësit	Numri tatimor i shitësit	Lloji i transaksionit	Shifra e instrumentit	Shifra e valutës	Kursi	Shuma në valutë origjinale	Shuma në denarë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
7	-	10	7	13	7	13	2	2	-	-	-	-

*Numrat në tabelën e shënojnë numrin e karakterëve në fushën përkatëse tekstuale

Në kolonën nr. 1 Numri amëz i bankës shënohet numri amëz i bankës e cila e dorëzon raportin.

Në kolonën nr. 2 Numri rendor shënohet numri rendor i transaksionit të realizuar me klientin gjatë ditës për të cilën dorëzohet raporti.

Në kolonën nr. 3 Data e transaksionit shënohet data e realizimit të transaksionit. Gjatë shënimit të datës përdoret formati Dita.Muaji.Viti. Dita dhe muaji shënohen me nga dy numra arab, ndërsa viti me 4 numra arab (dd.mm.yyyy)

Në kolonën nr. 4 Numri amëz i blerësit nëse blerësi është person juridik shënohet numri amëz i personit juridik. Nëse blerësi është jorezident, atëherë në këtë fushë shënohet 9000XXX, ku XXX është shifra e shtetit të jorezidentit, e definuar në shtojcën 5 Shifrat e shteteve dhe organizatave ndërkombëtare nga akti me të cilin rregullohet mënyra e kryerjes së qarkullimit pagesor me shtetet e huaja. Nëse blerësi është person fizik rezident, në këtë fushë shënohet 1000000.

Në kolonën nr. 5 Numri tatimor i blerësit nëse blerësi është person juridik, shënohet numri tatimor i personit juridik. Nëse blerësi është jorezident ose person fizik, në këtë fushë nuk shënohet e dhënë.

Në kolonën nr. 6 Numri amëz i shitësit nëse shitësi është person juridik shënohet numri amëz i personit juridik. Nëse shitësi është jorezident, atëherë në këtë fushë shënohet 9000XXX, ku XXX është shifra e shtetit të jorezidentit, e definuar në shtojcën 5 Shifra të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare nga akti me të cilin rregullohet mënyra e kryerjes së qarkullimit pagesor me shtetet e huaja. Nëse blerësi është person fizik rezident, në këtë fushë shënohet 1000000.

Në kolonën nr. 7 Numër tatimor i shitësit nëse shitësi është person juridik, shënohet numri tatimor i personit juridik. Nëse shitësi është jorezident ose person fizik, në këtë fushë nuk shënohet asnjë e dhënë.

Në kolonën nr. 8 Lloji i transaksionit shënohet lloji i transaksionit varësisht se a bëhet fjalë për prompt, forward ose swap:

Përshkrim	Shifra
Transaksioni spot	22
Transaksionet forward	33
Transaksionet swap spot	44
Transaksionet swap forward	45

Në rast të swap transaksionit, bankat paraqesin të dhëna individuale për transaksionet spot dhe forward, ku transaksioni swap forward paraqitet në ditën e realizimit.

Në kolonën nr. 9 Shifra e instrumentit të pagesës shënohet shifra e instrumentit të pagesës, i cili është lëndë e shitblerjes në transaksion dhe atë:

Përshkrim	Shifra
Valuta të huaja	00
Çeqe	02
Para të huaja të gatshme me këmbyes të autorizuar	11
Letra kreditore	51
Kambiale	52
Akreditiva dokumentare	55

Në kolonën nr. 10 Shifra e valutës shënohet shifra e valutave të definuara në shtojcën 6 nga akti me të cilin rregullohet mënyra e kryerjes së qarkullimit pagesor me shtetet e huaja.

Në kolonën nr. 11 Kursi shënohet kursi i dakorduar i transaksionit, i shprehur me 4 vende decimale pas presjes.

Në kolonën nr. 12 Shuma në valutë origjinale shënohet shuma e mjeteve, të shprehura me numra të plota, e cila është lëndë e shitblerjes në transaksionin konkret, në valutë origjinale.

Në kolonën nr. 13 Shuma në denarë shënohet shuma e mjeteve në denarë, të shprehura me numra të plotë, të llogaritur sipas kursit të dakorduar.

6. Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, Udhëzimi për mënyrën dhe kushtet e shitblerjes me mjete të huaja pagesore në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/05) ndalon së vlejtori, përveç pikave 55, 56 dhe 57 të cilat do të ndalojnë së vlejtori me ditën e fillimit të zbatimit të këtij udhëzimi.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e tetë prej ditës së publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe do të zbatohet nga 1 shtatori 2014.

U. Nr. 21475
26 qershor 2014
Shkup

Guvernator
Димитар Богов